

## SKEMA E VLERËSIMIT

Gjuhë shqipe

---

### AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

---

#### PËRGJIGJET E KËRKESAVE TË TESTIT (SKEMA E VLERËSIMIT)

Kjo është një skemë vlerësimi, në të cilën jepen **disa orientime** lidhur me vlerësimin e përgjigjeve të nxënësit.

- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
  - Testi ka 25 pyetje.
- 

#### PJESA I

Pyetja 1	B	1 pikë
Pyetja 2	D	1 pikë
Pyetja 3	C	1 pikë
Pyetja 4	D	1 pikë
Pyetja 5	B	1 pikë
Pyetja 6	A	1 pikë
Pyetja 7	B	1 pikë

---

**Pyetja 8 (a)**                      **1 pikë**

#### Model përgjigjeje

➤ Vajzës i erdhi keq, sepse qeni ishte i plagosur rëndë dhe nuk lëvizi kur ajo iu afroa.

**1 pikë**                      Nëse përgjigjja e dhënë i përmbahet idesë së dhënë më sipër.

**0 pikë**                      Përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

---

## SKEMA E VLERËSIMIT

Gjuhë shqipe

---

### Pyetja 8 (b) 1 pikë

Model përgjigjeje

- Qeni e kuptoi se vajza e donte, pasi ajo i shpëtoi jetën.

OSE

- Qeni e kuptoi se vajza ishte si një mik për të.

**1 pikë** Nëse tregon pse qeni nuk u largua nga vajza.

**0 pikë** Përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

*Shënim:*

*Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk për afrohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plota.*

---

### Pyetja 8 (c) 3 pikë

Model përgjigjeje

- Në fillim vajza ishte *armiqësore* dhe *mosbesuese*.
- Më pas ajo fillon të kujdeset (*e kujdesshme, e përkushtuar*).
- Në fund ajo *shqetësohet* për qenin dhe fillon ta dojë (e kërkon kur nuk e gjen dhe i vendos një emër).

**3 pikë** Nëse tregon të tri gjendjet shpirtërore të vajzës kundrejt qenit.

OSE

**2 pikë** Nëse tregon dy gjendjet shpirtërore të vajzës kundrejt qenit.

OSE

**1 pikë** Nëse tregon vetëm një gjendje.

**0 pikë** Përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

*Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk për afrohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plota.*

---

**Pyetja 9**

**3 pikë**

**Model përgjigjeje**

- *E hodhi qenin në shpatulla;*
- *I pastron plagën me shkop;*
- *La ujë për qenin;*
- *I dha ujë për të pirë;*
- *I dha për të ngrënë;*
- *I vendosi një emër, etj*

**3 pikë** Nëse zbulon në fragment tri raste, që tregojnë përkujdesjen e vajzës ndaj qenit.

**2 pikë** Nëse zbulon në fragment dy raste, që tregojnë përkujdesjen e vajzës ndaj qenit.

**1 pikë** Nëse zbulon në fragment një rast, që tregon përkujdesjen e vajzës ndaj qenit.

**0 pikë** Përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

---

**Pyetja 10 (a)**

**2 pikë**

**Ndjenja e frikës:**

- *Kjo më la pa frymë;*
- *Qëndrova në vend;*
- *Duke mos ditur ç'të bëja;*
- *Atë natë fjeta sipër shkëmbit.*

**Ndjenja njerëzore;**

- *Nuk di të them pse nuk e godita*
- *E tërhoqa me shumë kujdes shtizën;*
- *Befas u ndjeva keq;*
- *I lashë ushqim.*

**2 pikë** Nëse zbulon në fragment nga një moment, që ilustron secilën ndjenjë që përjeton vajza.

**OSE**

**1 pikë** Nëse zbulon në fragment një moment, që ilustron vetëm një nga ndjenjat që përjeton vajza.

**0 pikë** Përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

---

## SKEMA E VLERËSIMIT

### Gjuhë shqipe

---

#### Pyetja 10 (b) 3 pikë

##### Model përgjigjeje

- Triumfon ndjenja njerëzore.

##### Argumentimi

- Pavarësisht nga luhatjet, ndjenja njerëzore fillimisht, në mënyrë instiktive, e shoqëron ndjenjën e frikës. Më pas këto veprime instiktive kthehen në veprime të domosdoshme, pastaj në të dëshirueshme. Vajza ndjen shqetësim për qenin, ndan ushqimin me të dhe në fund shqetësohet kur nuk e sheh.

**1 pikë** Nëse përcakton se është ndjenja njerëzore ajo që triumfon.

##### DHE

**2 pikë** Nëse argumenton në mënyrë të plotë mendimin e tij.

##### OSE

**1 pikë** Nëse argumenton në mënyrë të pjesshme mendimin e tij.

**0 pikë** Përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

*Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk për afrohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plota.*

---

#### Pyetja 11 (a) 1 pikë

##### Model përgjigjeje

- Nëse di si të sillesh me kafshët, mund të bëhesh mik me to.

##### OSE

- Edhe kafshët më të egra mund të bëhen mik me to nëse ti tregon përkujdesje dhe dashur.

##### OSE

- Është e vështirë të krijohet miqësi midis njeriut dhe kafshëve, por jo e pamundur nëse di si ti duash.

Etj

**1 pikë** Nëse formulon një mesazh, i cili është në përputhje me përmbajtje e pjesës.

**0 pikë** Përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

*Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk për afrohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plota.*

---

## SKEMA E VLERËSIMIT

### Gjuhë shqipe

---

#### Pyetja 11 (b) 1 pikë

1 pikë Nëse shkruan një titull tjetër për pjesën e dhënë.

0 pikë Përgjigja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

---

### PJESA II

Pyetja 12 A 1 pikë

Pyetja 13 C 1 pikë

Pyetja 14 2 pikë

1 pikë midis: parafjalë

1 pikë ngulazi: ndajfolje

Pyetja 15 4 pikë

Folja: të shtrihesha

1 pikë mënyra lidhore

1 pikë koha e pakryer

Folja: mendova

1 pikë mënyra dëftore

1 pikë koha e kryer e thjeshtë

Pyetja 16 2 pikë

1 pikë mbiemri: të verdhë

1 pikë shkalla: pohore

Pyetja 17 A 1 pikë

Pyetja 18 2 pikë

1 pikë të tjerë: përemër i pacaktuar

1 pikë e tij: përemër pronor

Pyetja 19 1 pikë

1 pikë Shtiza, arma më e përshtatshme.

Pyetja 20 A 1 pikë

Pyetja 21 2 pikë

1 pikë kundrinori: prej tij

1 pikë lloji: kundrinor i zhdrejtë me parafjalë

---

## SKEMA E VLERËSIMIT

### Gjuhë shqipe

---

**Pyetja 22**      **A**      **1 pikë**

**Pyetja 23**      **D**      **1 pikë**

**Pyetja 24**                      **3 pikë**

**1 pikë**                      asnjëherë (shkruhet bashkë)

**1 pikë**                      s'kishte (duhet apostrofi)

**1 pikë**                      madhërishtme (vendosja e ë)

---

**Pyetja 25**                      **6 pikë**

### Kriteret e vlerësimit

**KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË**                      **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- argumenton se cilin do të zgjedhë: të lexojë një libër apo të shikojë një film që trajton të njëjtën ngjarje;
- shprehet qartë, përmes detajeve dhe shprehjeve të përzgjedhura, për ndikimet që ka pasur;
- përdor ilustrime mbështetëse;
- ka qartësi mendimi.

**KRITERI II: STRUKTURA**                      **1 pikë**

- respekton elementet e një eseje:
  - hyrjen
  - zhvillimin
  - përfundimin

*Nxënësi merr 1 pikë nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.*

*Nëse mungon njëra prej tyre, ai do të marrë 0 pikë për këtë rubrikë.*

**KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI**                      **1 pikë**

- krijon, përmes gjuhës që përdor, një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë;
- ka fjalor të pasur;
- ka stil origjinal;
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.

**KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE**                      **2 pikë**

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore;
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta;
- ka saktësi drejtshkrimore.